

# KRYEKISHA E SHËN GJERGJIT KËNDON LITURGJINË E 100-të TË SHENJTË NOLIANE

Nga ROZI THEOHARI- Boston

NË VITIN E JUBILEUT—2008

Viti 2008 ka qenë viti i Apostolatës së Kishës Ortodokse Shqiptare në Amerikë, vit i përkujtimit të 100- vjetorit të kryekishës së Shën Gjergjit—kryeqendra e historisë dhe e kronikave të dioqezës së kishave ortodokse shqiptare të Amerikës së Veriut. Ky ka qenë një vit i ngarkuar me veprimtari, festime, përvjetore e të diela përkujtimore për shqiptaro-amerikanët e Bostonit dhe rrethinat e tij. Qendra e këtyre ngjarjeve historike ka qenë kryekisha e Shen Gjergjit, e cila filloi qysh në janar 2008 me festimin e Theofanisë së shenjtë në kujtim të ditëlindjes së Fan Nolit dhe në nderim të emrit të tij. Përkujtimet vazhduan më 9 mars 2008 me celebrimin e Meshës Peshkopale të organizuar nga At Arturi, kancelari i kishes ortodokse të Bostonit, e të drejtuar nga hirësia e tij peshkop Nikon Liolini dhe hirësia e tij peshkop Ilia Ketri, në përkujtimin e 100-vjetorit të liturgjisë së parë hyjnore në gjuhën shqipe, të meshës së parë shqipe në kryekishën e Shën Gjergjit në Boston dhe të krijimit të Kishës Autoqefale Shqiptare. Në meshën peshkopale merrte pjesë edhe Lumtëria e tij kryepeshkopi Anastas Janullatos, i cili erdhi për të nderuar veprën e Fan Nolit. Mesha përfundoi kur At Liolini ngriti lart një kryq të artë, kryqi historik, i cili u përdor nga Fan Noli në meshën e parë shqipe të 1908-s...

Gjatë zhvillimit të meshës u përkujtua dhe dyvjetori i shkollës së Gjuhës dhe Trashëgimisë shqiptare, e cila u hap në Boston më 23 mars 2006. Tradita noliane e organizimit të shkollave shqipe pranë kishave shqiptare vazhdon edhe sot me po atë kujdes e me po atë përkushtim. Për të nderuar trashëgiminë e Nolit të madh, fëmijët e shkollës dhanë një koncert me këngë, vjersha dhe recitime të disa poezive të Fan Nolit dhe të poetëve të tjerë rilindës. Fëmijët mbanin lart e

tundnin tre flamurë të vegjël, flamurin shqiptar, flamurin e Kosovës dhe atë amerikan... Në shërbimin kishtar dhe në drekën përkujtimore organizuar në restorantin e patriotit shqiptar Anton Athanasi morën pjesë shumë shqiptaro-amerikane të të gjitha besimeve fetare, trojeve etnike dhe ideve të ndryshme. Gjithashtu morën pjesë edhe të ftuar joshqiptarë dhe kjo është një trashëgimi e Nolit kosmopolit.

Në shërbesën e 11 majit 2008 në kryekishën e Shën Gjergjit për të festuar “Ditën e nënës”, At Liolini dha një informacion interesant në lidhje me historikun e ndërtesës së kësaj kishe të Shën Gjergjit në South Boston. Sipas tij, më parë ndërtesa e kishës ishte një kishë amerikane, të cilën e frekuentonte si besimtare zonja Xhulia Vard Hove- abolicioniste, shkrimtare dhe nismëtare e festimit të “Mother’s Day” (Dita e Nënës) në Amerikë dhe autore e himnit amerikan “Battle Hymn of the Republic”. Pra, Xhulia, kjo grua kaq e rëndësishme dhe e njohur amerikane, ishte besimtare në kishën që më vonë u bë katedralja e Shën Gjergjit. Sipas At Liolinit, godina e kishës është ndërtuar në malin e Vashingtonit, në jug të Bostonit, në vitin 1872, tamam në kodrën historike ku, në vitin 1777, Xhorxh Vashingtoni, në luftën revolucionare amerikane ngriti topat në betejën që u zhvillua për të dëbuar flotën angleze nga qyteti i Bostonit... Më vonë, më 1872, ndërtesa e katedralit u ndërtua me stilin e arkitekturës së anijeve me vela. (Lagjja e Bostonit të Jugut është një ishull ku në shekullin e 19-të ndërtonin anije të tilla). Kjo arkitekturë quhet High Victorian Gothic dhe përmbledh disa forma të ndryshme të arkitekturës botërore: gotiken, rilindësen, barokun, klasiken, venecianen, toskanen, bizantinën. Ky kombinim arkitekturash, përfundon At Liolini, është principi se “ka shumë rrugë drejt Zotit”, kështu, në ndërtimin e një kishe mund të përdoren disa lloje elementësh arkitektonikë. E vendosur në një ambient të tillë, katedralja e Shën Gjergjit në Boston është një qendër interesante ku lidhet historia e Amerikës me historinë e lëvizjes kombëtare shqiptare.

...Më 15 qershor 2008, ditën e diel, u ndodha në katedralen e Shën Gjergjit në South Boston. Para shërbesës kishtarë, sa më pa, At Liolini më propozoi të këndoja në korin e kishës mbasi atë ditë mungonin disa këngëtare. Pranova me mëdyshje, nuk e kundërshtoja dot. Gratë e korit më pritën me përgëzime. Qëndroja pranë sopranos Dita Katsis, e lindur në SHBA nga prindër shqiptarë e që nuk e fliste mirë shqipen... Ndërkaq në podium At Liolini tha se sot është përkujtimi i 50 ditëve pas pashkës. “Ne në shqip i themi “Rrushajat”, -tha At Liolini, - “Rru” vjen nga sanskrishtja, që në shqipen do të thotë: “të të ngulitet në mendje...” “Erdhi shpirti i

shenjtë...” Kuptimi i dytë i Rrushajave: Në këtë ditë u kthye në atdhe Skënderbeu. Poeti Longfellow e ka përmendur këtë në poemën e tij dhe Noli e ka përkthyer në shqipe,” - vazhdoi At Liolini, i cili, si gjithnjë, shërbesën kishtare e kthen në një auditor.

At Liolini tregoi në të majtë të altarit ikonën e Jezu Krishtit, i cili mban në dorë një libër të hapur ku shkruhet në shqipe:

“ Unë jam drita e botës

Ay që më vjen pas nuk do të baresë në errësirë

Po do të ketë dritën e jetës”

Sa herë i lexoj këta rreshta, më shkon mendja tek troparet e përkthyer nga Fan Noli. Pikërisht në atë çast drejtuesi i korit më dha dy libra të himneve. Njeri prej tyre i vjetër, libri i tropareve përkthyer nga Fan Noli e botuar më 1936 me titull “ Hymnore për kor të përzier”. Libër i vjetër nga përdorimi, e shfletoj... At Liolini në podium, këmben dialog me korin. Duke replikuar me At Liolinin, më dukej sikur replikoj me Fan Nolin, në të njëjtin podium, në të njëjtin altar, në të njëjtin vend të korit, 40 vjet më vonë... Ndryshe të ndjekësh korin nga salla e kishës e ndryshe të këndosh vetë atje... Dita, në të majtën time, më tundi lehtë krahun. Ishte koha për replikën tonë “ Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt—Tani e përherë dhe në jetë të jetëve, Amin!” Unë kisha humbur në leximin e “hyrjes” së librit të tropareve shkruar nga Fan Noli. Ja fjalët e tij: “Ky libër përmban melodi tradicionale ruse...melodi tradicionale ruse te Kievit...melodi tradicionale bizantine...melodi të shkruara e të harmonizuara prej kompozitorësh rusë të dëgjuar, emrat e të cilëve shënohen nën titullin...Sa për meloditë tradicionale bizantine, këto i kam harmonizuar vetë nën udhëheqjen e profesorit të Harmonisë z. Varren Storey Smith në New England Conservatory of Music, të cilit po i shfaq këtu botërisht falënderjet e mia...Urojmë me gjithë zemër që ky libër të hyjë në punë për të mirën e Kishës Kombëtare këtu e në Shqipëri.(Boston, Mass., Janar 15, 1936)

Tropari i Shën Gjergjit, (përkthyer nga Noli):

“Si çlirimtar i robërve dhe mprojtës i të vobekëve , mjeku i të sëmurëve dhe perluftar i mbretërve, dëshmor i math Shën Gjergj trope-prurës, nërmjeto te Krishti Perëndia jonë të

shpëtohen shpirtet tona.”...Unë këndoja në shqipe troparet e përkthyer të Imzot Nolit, në kishën e tij, dhe nuk i mbaja dot të rrahurat e zemrës.

... Ditën e 23 shtatorit 2008 në City Hall Plaza, në bashkinë e Bostonit u organizua Parada vjetore e bostonianëve të rinj me pjesëmarrjen e të gjitha grupeve etnike të Bostonit dhe rrethinat e tij. Dhe pikërisht, në mes të dhjetëra flamujve e kostumeve folklorike që përfaqësonin komunitetet e ndryshme, spikaste flamuri ynë kombëtar, i cili e filloi paradën. Shpresa Theodhosi, e njohur tashmë në komunitetin shqiptaro-amerikan si një drejtuese e zonja, por edhe si një organizatore e patriote, parakaloi veshur me kostumin kombëtar shqiptar trashëguar nga stërgjyshja e saj. Pas Shpresës vinin shumë të rinj shqiptarë veshur me kostumet kombëtare. Duke tundur flamurin shqiptar dhe atë kosovar, zëri i të rinjve oshëtinte “Kosova”, “Kosova”, shoqëruar nga orkestra braziliane prej 15 tamburxhinjsh. Në një çast, Shpresa rrëmbeu mikrofonin dhe bërtiti: “Kosova, the newst European country!” (Kosova, shteti më i ri në Evropë). Është për t’u nënvizuar se parada u shoqërua edhe nga shqiptaro-amerikanët e moshuar, ose siç quhen “bostonianët e vjetër”, të cilët nuk pushuan së pruri grupe amerikanësh në stendën shqiptare për t’ua bërë të njohur Shqipërinë e Kosovën. Sipas Shpresa Theodhosit, Shqipëria u paraqit më mirë nga vendet e Evropës, shumë nga të cilat nuk morën pjesë në këtë festival. “Sidoqoftë,- tha ajo,- ne shqiptarët mund të përfaqësonim edhe kontinentin evropian. Pse jo? Kur konsiderohemi një nga popujt më të vjetër të Evropës!”

Suksesi i shqiptarëve në këtë paradë ishte preludi i festës së pritshme, më 27 shtator 2008, Grand-Gala e 100-vjetorit të themelimit të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare.

## MIRË SE ERDHËT, PRESIDENT TOPI

Vizita e Presidentit shqiptar Bamir Topi në Amerikë përkoi në një kohë kur fjala “president” artikulohej më shumë se kurrë në mediat amerikane. Natën e mbërritjes së zotit Topi në Boston zhvillohej debati i parë mes dy kandidatëve për presidentin e ardhshëm amerikan, Obama dhe Mekein...Presidenti Topi u prit nga një grup shqiptaro-amerikanësh në hyrjen e Bibliotekës “Kenedi” ditën e shtunë më 27 shtator 2008. Presidenti ynë shqiptar erdhi të bënte

nje vizitë në Bibliotekën- Muzeum “Kenedi” i shoqëruar nga ambasadori i Republikës së Shqipërisë në SHBA Aleksandër Sallabanda, nga konsulli i nderit i Massachusettsit Stefan Koçi, nga dy bashkëkryetarët e shoqërisë MASS/BESA Albana Orgocka e Mark Kozmo, nga kryetari i shoqatës së Shqiptarëve të Kosovës z. Agim Sejdiu, si dhe nga përfaqësues të tjerë të organizatave shqiptaro-amerikane të Bostonit.

Në minutat kur prisnim presidentin, u takova me konsullin e nderit të Michiganit, zotin Ekrem Bardha. “Është një ditë e gëzuar për mua,- tha ai,- mirë se na erdhi presidenti shqiptar!...Në kohën e qeverive komuniste kemi qenë të shpëputur nga atdheu...Sot s’ka më kufij e ndalesa...I ftoj biznesmenët shqiptaro-amerikanë të investojnë në Shqipëri...ta duam e të kujdesemi për atdheun tonë...”

Shqiptaro-amerikani Paul Pando, një mesoburrë, bir i një familjeje emigrantësh nga Braintree, Mass., na tha me krenari se edhe ai ishte shqiptar. Me aparat fotografik varur në qafë, ai vej e vinte nëpër hollin e katit të parë të muzeumit, në gatishmëri për të fotografuar presidentin shqiptar...Kur e pyeta për Fan Nolin, ai, me një të folur karakteristike të bostonianëve të vjetër, më tregoi se nuk e harronte kurrë fytyrën e Imzot Nolit atë ditë të meshimit kur ia kishte incizuar zërin dhe e ruante kasetën si relike. Z Pando më shpjegoi gjithashtu se i donte shumë Shqipërinë dhe shqiptarët, se kishte punuar disa vjet si inxhinier civil në Shqipëri, duke ndihmuar në ndërtimin e infrastrukturës së qyteteve. Ai kishte mbetur i befasuar nga pritja e ngrohtë që i ishte bërë nga “vëllezërit e vatanit”...Më tej, një grup studentësh nga Universiteti i Bostonit dhe ai i Harvardit ndjeheshin krenarë që një president shqiptar vizitonte Amerikën, i pritur me respekt e nderime. “Ky fakt na lartëson edhe ne si studentë shqiptarë”, - thanë ata.

Përtej murit të xhamtë dalluam zotin Topi dhe shoqëruesit e tij që po i afroreshin ndërtesës. Posa na pa e na njohu që ishim shqiptarë, presidenti Topi kaloi barrierën e ndalim-kalimit e u gjend mes nesh. “Mirë se na erdhët!” , thamë ne. Ai na përshëndeti buzagas e tokëm duart. Pastaj na njohu me bashkëshorten, Teutën, dhe vajzën, Nadën. Unë shtrëngoja në dorë një degë të lules barbarosë (idërsha), të cilën e kisha vendosur në një vazo të vogël, lidhur me një fjongo të bardhë. Mes emocioneve ia dorëzova këtë degëzë luleje presidentit si dhe një letër drejtuar çiftit Topi:

I nderuar Zoti President Topi,

E nderuara Zonja e Parë Teuta,

Mirë se na erdhët në Bostonin shekullor, në kryeqytetin e emigrantëve shqiptarë.

Jam e gëzuar t'ju pres me një degë të lules barbarosë (idërsha), e cila ka një histori të gjatë këtu në diasporën e Bostonit. Këtë lule e ka sjellë nga Kosova e Përmetit një nuse e re emigrante shqiptare, Aretia, kur u martua në vitin 1911 me një emigrant përmetar. Aretia e pruri të mbjellë në një vazo dhe barbarosa iu përshtat shumë mirë klimës së Nju-Inglandit. Gratë përmetare e përdorin idërshanë për t'u dhënë aromë të mirë likove të tyre te famshme, traditë e cila u ndoq edhe në Amerikë. Qysh prej vitit 1911 barbarosa lulëzonte nën kujdesin e Aretisë e vite më vonë nën kujdesin e vajzës së saj Sofisë. Sofia, mikja ime 87-vjeçare, kujtonte gjithnjë se, sa herë shkonin me familjen në kishën e Shën Gjergjit, i shpinin Fan Nolit një degëzë barbarosë. Ai i falënderonte dhe e vendoste lulen në altar...Në vitin 2003, para se të sëmurej e të vdiste Sofia ma dhuroi mua vazon me lulen e shtrenjtë të barbarosës, duke ma lënë amanet të kujdesem për të.

Kjo lule historike është simbol i vazhdimësisë së grupit etnik të shqiptarëve në komunitetin e Bostonit, është simbol i dashurisë dhe zemërdhembshurisë së shqiptaro-amerikanëve për vendlindjen e paharruar.

Me respekt, R.TH.

Presidenti ynë u prit me nderime nga anëtarët e stafit të Muzeumit, të cilët e shoqëruan në të gjitha pavijonet, ekspozitat dhe mjediset e brendshme. Biblioteka "Kenedi" ka një arkitekturë interesante, si një libër i madh i bardhë gjysmë i hapur në hapësirë dhe është ndërtuar nga ndihmat private të dhuruara nga 36 milionë njerëz nga e gjithë bota. Presidenti Topi dhe personat që e shoqëronin vizituan e panë ekspozitat, fototekën, dokumentet, stendat, filmat etj. mbi jetën e Kenedit dhe karrierën e tij, e cila kulmoi me zgjedhjen e tij si presidenti i 35-të i SHBA. Tashmë dihet vizioni kenedian : "One person can make a difference, and every person should try" (Një person mund të bëjë një ndryshim dhe çdo person duhet ta provojë këtë).

Ishte ngjethës çasti kur vizitorët shqiptarë kaluan para një cope konstruksioni të shkëputur nga muri i Berlinit... Të ruhemi nga muret!... Sidoqoftë, sot bota ka ndërruar fytyrë!... Dikur, Noli i vetmuar, i lodhur e i sëmurë, deri në vitin 1965 kur ndërroi jetë, përpiquej të takohej me

presidentë e kongresmenë amerikanë, sepse preokupim të çastit e të së ardhmes kishte “bërjen e Shqipërisë”. Sot, një president shqiptar i mirëpritur dhe i nderuar nga qeveria dhe Senati amerikan, falënderon dhe shfaq mirënjohjen për Amerikën, për miqësinë, për ndihmën dhe mbrojtjen që i ka dhënë kombit shqiptar. Këtu përfshihet edhe ëndrra e Fan Nolit.

Në mbarim të vizitës presidenti Topi shkroi një mesazh në librin e përshtypjeve. Gjithashtu kryetari i stafit i dhuroi zotit Topi një bust të presidentit Kenedi...Në një bufe të vogël, organizuar për nder të presidentit tonë (ku edhe pjatat e porcelanit ishin katrore, si faqe libri), kryetari i stafit e informoi zotin Topi edhe për karrierën e dy vëllezërve të tjerë Kenedi. Ai tha se senatori demokrat Eduard Kenedi, kur është fjala për interesat e Amerikës, është tolerant dhe afrohet edhe me republikanët. Zoti Stefan Koçi shtoi me nderim se po të njëjtat cilësi analoge zotëronte edhe presidenti shqiptar Topi.

Po atë ditë presidenti Topi u prit me dashuri në qytetin e Kuincit, Mass., në restorantin “Alba” nga shqiptaro-amerikanët dhe nga pronari i restorantit Leo Keka. Qysh në hyrje të lokalit të binte në sy një tortë e madhe dizenuar me flamurin e kuq e me shqiponjën e zezë, ku ishte shkruar: “Mirë se erdhe, Presidenti Topi”. Me bujarinë e tij, zoti Keka kishte ftuar rreth 200 miq shqiptarë e amerikanë, të cilët u takuan me presidentin dhe dëgjuan me vemendje një fjalim të shkurtër përshëndetës. Zoti president përmendi ndihmën dhe angazhimin e qeverisë amerikane për Shqipërinë e Kosovën dhe shfaq mirënjohjen e popullit shqiptar ndaj Amerikës. Më tej presidenti uroi emigrantët shqiptarë për sukseset e arritjet në punën dhe jetën e tyre të vështirë të mërgimtarit. Të pranishmit e duartrokiten presidentin dhe i uruan mirëseardhjen...Në restorantin “Alba” presidenti Topi pati një takim pune me të gjithë konsujt e nderit të Republikës së Shqipërisë në SHBA.

I ftuar në këtë drekë ishte dhe kongresmeni i Kuincit Mr. Villiam Delahunt. Ndërsa gazeta lokale e Kuincit “The Patriot Ledger” lajmin për ardhjen e presidentit shqiptar në Kuinci e fillonte: “Megjithëse Kuinci është qytet i presidentëve, jo çdo ditë shohim të ftuar ndonjë udhëheqës shteti!...” Gazeta intervistonte zotin Keka dhe përshkruante gëzimin e mirënjohjen që ai ndiente për ardhjen e presidentit shqiptar.

Me të njëjtën dashuri e mirënjohje u prit presidenti të nesërmen në restorantin “Vlora” në Boston nga 170 shqiptaro-amerikanë, kryesisht intelektualë, publicisti Van Kristo, prof. Myzafer

Çela, studiuesi Agron Alibali, prof. Thanas Gjika, Shpresa Theodhosi, Artisti i merituar Xhoni Athanas, Bashkim Braho, studentët e Universitetit të Bostonit e të Harvardit e të tjerë. Mes tyre takova prof. Myzafer Çelën, ish- pedagogu i presidentit Bamir Topi. “Takova sot presidentin Topi,- tha ai i emocionuar.- Presidenti u befasua shumë kur u takuam...biseduam...I vemendshëm deri në hollësira...Ruaj përshtypjet më të mira për personin e tij, si ish- student dhe si president...” Presidenti u përshëndet për zemërsisht edhe me disa kuadro të tjerë të bujqësisë, ish- kolegët e tij, që kishin ardhur për ta takuar.

Pasi pronari i restorantit Aldo Velaj mirëseardhi presidentin dhe të ftuarit, përshëndeti konsulli i nderit z Stefan Koçi, i cili tha “ Mirë se na erdhët, zoti president, ju ftojme të na vini edhe herë të tjera!” Pastaj ai falënderoi zotin A. Velaj për mikpritjen e veçantë dhe e vlerësoi jo vetëm për punën, por edhe për aktivitetin në shërbim të komunitetit. Z Stefan tha se gjatë drekës do të informojmë presidentin për aktivitetin e komunitetit të Bostonit.

Takohem me zonjën amerikane Xhein Kristo dhe bashkëshortin e saj zotin Van Kristo, bostonian i vjetër, miku i Fan Nolit dhe veprimtar i shquar i diasporës së Bostonit. Z Kristo flet mirë në gjuhën shqipe e me emocion kujtoi çastin kur bashkëshortja e tij Xhein, për ndihmën dhe kontributin dhënë Shqipërisë, mori medaljen e mirënjohjes nga presidenti Moisiu. “Dhe ja tani, - vazhdoi ai,- u takuam me një president të ri të Shqipërisë, zotin Topi, me gruan dhe vajzën e tij. Gëzohem se presidenti është një burrë i ri, do të ecë në rrugë të drejtë dhe do të japë energjitë e tij që Shqipëria të afrohet më shumë me komunitetin e Evropës...” I drejtohem zonjës Xhein: “Jam shumë e lumtur,-tha ajo,- të ndodhem sot këtu, në këtë restorant të mirë...është kënaqësia jonë që u njohëm me presidentin dhe familjen e tij. Zonja e tij është “good lady”. Unë i uroj Shqipërisë përparim të mëtejshëm...Shqipëria është një vend i mrekullueshëm e i bukur...e dua! Ne amerikanët do ta mbështetim e ndihmojmë Shqipërinë.”

Në fjalën e tij presidenti Topi falënderoi zotin Velaj dhe pjesëmarrësit e drekës, një pjesë e të cilëve ishin miq e të njohur të tij. “Në një moment, kur jam i qetë, mendoj ku janë njerëzit që i shihja përditë... miq të afërm e të largët. Pikërisht, në emigracion, në këtë drekë unë u takova me miq dhe provoj shumë emocione. Edhe për një fakt tjetër, gjej këtu atë që shqiptarëve nuk u ka munguar kurrë asnjëherë, gjej mikpritjen shqiptare në Amerikë, në një vend që shumë e kemi ëndërruar e shumë prej jush e kanë bërë realitet...Jemi në vendin e lirisë, në vendin aleat të Shqipërisë, kur në ditët shumë të vështira ne kemi gjetur strehë. Dhe sot jemi në një moment kur

marrëdhëniet me SHBA janë më të forta se kurrë!...Ne jemi aleatë, jemi partnerë dhe vendimi i fundit i Senatit amerikan që Shqipëria të marrë pjesë me të drejtat tona në Nato tregon që ne jemi në marrëdhënie të mira. Unë dëshiroj të falënderoj gjithë komunitetin shqiptar këtu, në mënyrë të veçantë të falënderoj Aldo Velajn për këtë mikpritje në restorantin e tij “Vlora”. Unë preferoj të shkoj në Vlorë. Vlora është jo vetëm e bukur, por ka edhe njerëz që janë ekspresivë: çfarë kanë në zemër, e nxjerrin përjashta dhe jam fatlum që kam shumë miq nga Vlora. Sot bëra edhe një mik të ri.” Pastaj presidenti shtoi me humor: “ Pashë në meny se kini edhe peshk, por jo si ai i Vlorës!”

Në përfundim të fjalës presidenti uroi emigrantët për sukseset. “Gëzohem që keni bërë progres, nuk është e lehtë, por ka patur disa gjenerata emigracioni deri sot mes jush dhe sot unë shoh që ka njerëz kompetitivë në të gjithë jetën e SHBA ...Pata rastin të takoja edhe profesorët e mi, profesor Myzaferin, të cilët kanë lënë gjurmë në karrierën time, sepse jemi formuar pikërisht në atë proces hap pas hapi. Njeriu nuk mund të gdhihet rastësisht në karrierë, aq më shumë president! Unë falënderoj të gjithë profesorët e mi, miqtë e mi, të gjithë dashamirësit, të cilët më kanë dhënë mundësinë që të jem këtu...Njeriu e merr këtë titull për të qenë i angazhuar për t’i shërbyer Shqipërisë, interesave të Shqipërisë, gjithë shqiptarëve kudo ku janë. Dhe në këtë rrugë që kam bërë në SHBA, kam qenë i lumtur që kam folur për Shqipërinë, por kam folur edhe për Kosovën.

Ju falënderoj edhe një herë për mikpritjen, ju falënderoj që ju demonstroi çdo moment për Shqipërinë. Së bashku me ambasador Sallabandën që e kam këtu, kemi biseduar për ju... Çdo person që bën vepra të mira në emigracion, është një ambasador për kombin tonë të përbashkët. Dëshiroj të ngremë një gotë për gjithë shqiptarët, për miqësinë tonë me Amerikën, për familjet tuaja dhe fati t’ju ndihmojë në jetë. Gëzuar!”

Më tej e mori fjalën bashkëkryetarja e shoqatës MASS/BESA Albana Orgocka: “ I nderuar zoti President, në emër të shoqatës së shqiptaro-amerikanëve të Massachusetts “Besa”, ju uroj mirëseardhjen në Boston. Komuniteti shqiptaro- amerikan në Massachusetts, ka pasur një rritje të madhe në 10-15 vitet e fundit dhe së bashku me këtë rritje ka ardhur dhe një ndryshim në dinamikat e diasporës shqiptare këtu në Boston. Për t’ju përgjigjur këtyre dinamikave dhe nevojave të reja të komunitetit shqiptar, shoqata “Besa” ka një mision, jo vetëm të promovojë

mirëqënien dhe perparimin e komunitetit shqiptaro-amerikan në Massachusetts, por edhe të mbrojtë dhe të ruajë gjuhën, kulturën si dhe traditat shqiptare me qëllimin afatgjatë të krijimit të një qendre social kulturore shqiptare të përhershme.

Si fillim ne krijuam një listë informatike të mbi 3000 shqiptarëve në Massachusetts, me qëllim që të komunikojmë me një kontigjent sa më të madh të diasporës. Një nga arritjet kryesore të shoqatës ka qenë hapja e Shkollës së Gjuhës dhe Trashëgimisë shqiptare, e cila që në mars të vitit 2006 u mëson femijëve shqiptarë të diasporës jo vetëm të shkruajnë dhe të lexojnë gjuhën shqipe, por edhe të mësojnë historinë dhe kulturën e pasur të nënave dhe gjyshërve të tyre që dhe ata të ndjehen krenarë për këtë histori dhe për të ditur se nga kanë ardhur. Shkolla tani ka rreth 30-40 studentë dhe zhvillohet në mjediset e Universitetit të Bostonit dhe të kryekishës së Shën Gjergjit.”

Sipas Orgockës, në nivelin humanitar, shoqata “Besa” ka krijuar një fond asistence për shqiptarët në nevojë. Para një viti gjithë komuniteti shqiptar dhe kosovar në Massachusetts u mobilizua për të hapur fonde për t’u ardhur në ndihmë 5 femijëve nga Kosova që ishin viktimë të një zjarri, me djegie të rënda në fytyrë dhe në trup. Këta 5 femijë janë duke u trajtuar tek një nga spitalet më të mira në botë për djegie “Shriners” dhe shoqata po kujdeset në çdo hap të trajtimit të tyre, duke siguruar strehë dhe një ambient sa më të rehatshëm gjatë kohës së trajtimit.

“Si të gjithë shqiptarët kudo në botë edhe komuniteti shqiptar në Massachusetts,-vazhdoi ajo,- ka mbështetur pa rezerva përpjekjet e popullit kosovar për pavarësi, që nga demonstrimet para godinës së Kombeve të Bashkuara dhe deri në mbështetjen e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, kur edhe ne të gjithë së bashku festuam shpalljen e kësaj pavarësie.

I nderuar zoti President,

Komuniteti shqiptar në Boston, vazhdon të jetë një komunitet vibrant dhe në zhvillim, por në këtë zhvillim ne asnjëherë nuk harrojmë vendin mëmë dhe ndjekim nga afër zhvillimet në Shqipëri. Ne jemi shumë krenarë për punën tuaj si president i Shqipërisë dhe për aftësinë tuaj si udhëheqës për të kapërcyer vijat partiake dhe për të vënë mbi gjithçka interesat e popullit shqiptar. Unë ju shpreh mirënjohjen për përpjekjet dhe vendosmërinë tuaj për të ruajtur pavarësinë e institucioneve në Shqipëri. Në këtë mision meritoni respektin dhe mbështetjen tonë pa rezerva. Ju faleminderit.”

## DARKA E MADHE FESTIVE E 100- VJETORIT TË KRYEDIOQESËS ORTODOKSE SHQIPTARE NË AMERIKË

Për të ardhur deri te Grand- Gala, më 27 shtator 2008, duhet t'i referohemi shkurtimisht historisë 100-vjeçare nëpër të cilën kaloi diaspora shqiptaro-amerikane e Massachusettsit.

Qysh në emigracionin e parë, në fillim të shekullit të kaluar, emigrantët e ndien nevojën të bashkoheshin për t'i përballuar më mirë vështirësitë e mërgimit. Kështu, në janar 1905 u organizua në Boston "Vëllazëria mirëbërëse e Dardhës", e cila ishte shoqëria e parë e shqiptarëve e krijuar në bazë fshati...Po më 1905 u krijua shoqëria "Malli i Mëmëdheut" në Jamestown...Ardhja e Fan Nolit në Amerikë më 1906 dhe fillimi i veprimtarisë së tij në Boston, ishte një moment i rëndësishëm historik që shënoi edhe fillimet e bashkësisë etnike të emigrantëve shqiptarë në vitet e para të shekullit të kaluar. Dalja e gazetave të para "Kombi" e më vonë "Dielli", si dhe aktiviteti i "Vatrës" dhe i shoqërive dhe organizatave të tjera patriotike u realizuan me perpjekjet e Fan Nolit dhe bashkepunëtorëve të tij Faik Konica, Sotir Peci, Kol Tromara, Josif e Vasil Pani, Goni Katundi, Kristo Dako, Petro Nini Luarasi, Kostandin Demo e shumë të tjerë...Bostoni, djepi i demokracisë amerikane, u bë baza e fortë e perpjekjeve për pavaresinë e Shqipërisë dhe mbrojtjen e trojeve etnike. Është pa mbarim lista e aktiviteteve me karakter politik e social-kulturor të kryera në diasporën shqiptare të Massachusettsit, ashtu siç është pa mbarim edhe numri i shoqatave, organizatave, organeve të shtypit etj., të krijuara në periudha të ndryshme kohe, duke shtuar këtu edhe institucionet fetare... Shërbimi i parë liturgjik në gjuhën shqipe u celebrua në tokën amerikane më 22 mars 1908 në Knights of Honor Hall në Boston nga prifti shqiptar Theofan S. Noli. "Kohët kërkuan perpjekje të ngutshme,- ka thënë At Liolini,- për të krijuar një kishë, që t'u drejtohej emigrantëve shqiptarë në gjuhën e tyre, duke siguruar tekstet liturgjike dhe duke ruajtur ndërgjegjshmërinë e parimeve si në atdhe dhe vetëkëmbënguljen e mësuar këtu në Amerikë." Me aktin e tij të njeriut klerik, më 2008, Noli, njeriu erudit, përçoi dritë në gjithë kombin shqiptar. Sepse kjo nuk ishte thjesht një ngjarje kishtare, por një ngjarje historike me përmasa të tilla që edhe pas 100 vjetëve të ngjallë interes e të përcjellë një mesazh të madh në mbarë botën shqiptare... Dhe s'ke si të mos provosh një ndjenjë krenarie. Është krenaria që të frymëzon tradita shekullore, nderimi i bashkatdhetarëve tanë për kombin dhe vlerat e tij...

Federata “Vatra”, e larguar disa vjet më parë, sot zhvillon aktivitetin e saj ne Nju-Jork. Bostonit i ka mbetur vetëm emri i mire i para dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Iku “Vatra”, por kanë mbetur “vatranët”, të vjetrit e të rinjtë, të cilët po mundohen ta kthejnë Bostonin në një qendër kulturore për shqiptaret. Kohëve të fundit, një nga veprimtarët e dalluar të komunitetit, biznesmeni z. Stefan Koçi, është emëruar Konsull Nderi i përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë në Massachusetts, në vend të patriotit Anton Athanasi, i cili e mbajti këtë detyrë deri në fund të jetës. Tashmë është themeluar shoqata “Besa”- Shoqata shqiptaro-amerikane e Massachusettsit, funksionojnë Dega e Bostonit e Organizates Kombetare Shqiptaro-Amerikane (OKSHA), Dega e Massachusettsit e Keshillit Kombetar Shqiptaro-Amerikan (KKSHA), Shoqata për të drejtat e njeriut- “Çameria”, Shoqata e shqiptarëve kosovarë të Bostonit, Shoqata Mjekësore shqiptaro-amerikane, Klubi i studentëve shqiptarë në Universitetin e Bostonit, Klubi i studentëve të Universitetit të Harvardit- “Harvard College Albanian Club” etj. Veprimtaria e tyre na rrit besimin e palëkundur se vlerat e kombit dhe vetëdija jonë kombëtare do të trashëgohen e do të çohen më tej nga brezat që do të vijnë.

X X X

Është në nderin e diasporës shqiptaro-amerikane letra përshëndetëse e presidentit të Amerikës Xhorxh Bush: “Unë dërgoj përshëndetjet për 100- vjetorin e Kishës Autoqefale Ortodokse Shqiptare...Zemërdhembshuria juaj, puna e mirë dhe përkushtimi për familjen dhe besimin pasuron shoqërinë tonë e bëhet një shembull i mirë për të tjerët. Duke shpërndarë mesazhin e dashurisë së Zotit, ju ndihmoni të ngrini lart zemrat e ta bëni vendin tonë më paqësor...” Presidenti shqiptar Topi në letrën e tij përshëndetëse shkruan mes të tjerash: “ Fan Noli, ky apostull shqiptar, predikoi në gjuhën e bukur shqipe jo vetëm fjalën e shenjtë të Perëndisë, por shpërndau edhe zërin e shpirtit të Shqipërisë dhe të shqiptarëve...Fan Noli zgjodhi tempullin e lirisë boterore, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për të shpallur lirinë e shqiptarizmit...” Në letrën e tij presidenti i Universitetit të Harvardit, në Kembrixh, MA, zoti Drev Gilpin Faust, shkruan: “ Të dashur Ms. Toli, i përndershmi Liolin dhe zoti Cornetta: Jam i gëzuar të kem kënaqësinë t’ju përshëndes ju dhe anëtarët e kishës ortodokse shqiptare në Amerikë në 100- vjetorin e themelimit të kishës suaj nga kryepeshkopi Theofan S. Noli. Ne, në Harvard, ndiejmë një kënaqësi të veçantë për këtë ngjarje historike, që kryepeshkopi Noli ishte një student, një anëtar i respektuar i kolegjit tonë të vitit 1912 dhe sot ju kremtoni frutet e

bollshme të punës së tij. Një përvjetor 100-vjeçar është një etapë e rëndësishme historike...dhe unë ju uroj një festë të lumtur edhe në 100 vjetët e tjerë që do të pasojnë.” ...Kryekishës së Shën Gjergjit i kanë ardhur përshëndetje edhe nga senatori John Kerry, nga kryetari i Bashkisë së Bostonit Mr. Thomas Menino, nga guvernatori i Massachusettsit Mr. Deval Patrick, nga presidentja e keshillit të Bostonit Maureen Feency e personalitete të tjera.

X X X

Mbrëmja festive e 100- vjetorit u celebra në Qendrën Tregtare Botërore të Bostonit, më 27 shtator 2008, në orën 6 pas dite. Posa hymë te dera e ndërtesës, na vendosën në dorën e majtë një “byzlyk”, një shirit të kuq letre ku ishte stampuar një shqiponjë e zezë, si një shenjzë kombëtare pagëzimi. Salla e madhe e koktejlit filloi të mbushej pak nga pak me të 1000 pjesëmarrësit e të ftuarit ardhur nga gjithë anët e Amerikës e të botës. Në sallë ishin vendosur dy monitorë dhe piktura e Imzot Fan Nolit. I përndershmi At Liolin, kancelar i kryekishës ortodokse të Shën Gjergjit, organizatori kryesor i festimeve, ishte i kudondodhur duke mirëpritur përzemërsisht miqtë e të ftuarit, me merakun e të zotit të shtëpisë...Bostonianët e vjetër e të rinj, duke trokitur gotat me verë, uronin mirëseardhjen dhe përshëndesnin miqtë e të afërmit. Mes tyre – të ftuarit nga trojet etnike, nga besime fetare të ndryshme, nga përkatësi ideologjike të ndryshme, por të gjithë shqiptarë, me një dëshirë e një qëllim...Një mozaik veshjesh e stilesh të ndryshme grash e vajzash të reja të lëbyrnin sytë...Fëmijë të gëzuar, veshur bukur, që bridhnin ngeshëm...Tek-tuk të zinin sytë klerikët e nderuar të katër feve shqiptare: ortodoksë, myslimanë, katolikë e bektashianë...Hoxha me priftin takoheshin me njeri-tjetrin e përqafoheshin si të ishin miq të vjetër...Afrohem e përshëndetem me Baba Edmond Haradinajn, zëvendës kryetar i Kryegjyshitës Bektashiane në Tiranë. “Ndjem krenar që vij sonte këtu në këtë mbrëmje,- tha ai,- aq më teper që gjyshi im ka bërë pjesë në “policinë e Fan Nolit” (Kështu quheshin vullnetarët që morën pjesë në policinë kombëtare të Th. Gërmenjit në Korçë, më 1914.) Në emër të Kryegjyshitës botërore uroj sonte këtë festë dhe e bekoj.”

Metropolitani Joan Pelushi, peshkopi i Korçës më tha: “Përulem me nderim para Fan Nolit dhe kujtimit të tij...Ndiej gëzim që shoh sot në SHBA një ortodoksi të bashkuar. Uroj që kjo të ndodhë edhe në Shqipëri.”

Don Ndue Gjergji, famullitar i kishës katolike “Zoja Pajtimore” në Detroit, MI, tha: “ 100-vjetori i përkujtimit të themelimit dhe thënies së meshës së parë në gjuhën e bukur shqipe në South Boston është një ngjarje e rëndësishme në mbarë historinë e popullit shqiptar, për kishën ortodokse shqiptare dhe për ne katolikët, sepse jemi vëllezër të një besimi në Krishtin...Për mua është një gëzim i madh dhe uroj që ky përvjetor, të sjellë diçka të bukur mes nesh, një këndellje tjetër të jetës fetare, një lidhje të ngushtë më të mirë mes kishave tona.”

Imam Gazmend Agën të xhamisë shqiptare në Waterbury, CT, e kam takuar disa herë në Nju-Jork e në Boston gjatë kremtimit të festave kombëtare. Sonte ai shprehu kënaqësinë që merrte pjesë në këtë festim kaq të rëndësishëm dhe u fal për darkën e 100-vjetorit. “ Ndihem i lumtur,- tha ai,- të jemi sonte këtu klerikët e katër feve të ndryshme shqiptare , por me një burim të njëjtë...Zoti e bekoftë Shqipërinë dhe shqiptarët!”

I afrohem një grupi me gra bostoniane të moshuara, të cilat edhe sot bisedojnë me gjuhën e nënave, gjuhën shqipe. Dardharja Vasilika Kaçauni më tregoi se, kur ishte e re, bënte pjesë në korin e kryekishës së Shën Gjergjit: “Fan Nolin e kishim mësues muzike të korit,- kujton ajo.- Por Noli na jepte më shumë dijeni për muzikën: na mësonte notat, na praktikonte frymëmarrjen, na shpjegonte muzikën simfonike e llojet e tjera...Imzot Noli lodhej dy orë më këmbë duke folur, kurse ne pjesëtarët e korit rrinim ulur e dëgjonim. Ne çuditeshim sa i ditur ishte Noli ynë edhe në muzikë...” Të njëjtën gjë pohoi edhe Vangjelia Kostandini: “ Erdha 6 vjeçe nga Shqipëria në Boston dhe u regjistrova në shkollën e Shën Gjergjit. Aty e njoha për herë të parë Fan Nolin, i cili punonte shumë e me durim edhe me ne të vegjlit e shkollës e interesohej për përparimin tonë në mësimin e gjuhës shqipe...Kur u rrita, kam qenë edhe në korin e kishës, ku mësuesi ynë Imzot Noli, veç himneve kishtare, na mësonte edhe kulturën muzikore.” Nga Filadelfia kishte ardhur grupi më i madh i mysafirëve, i përbërë nga besimtarët e dy kishave shqiptare. Gratë e moshuara të Filadelfias u takuan përmallshëm me gratë bostoniane për të ndarë gëzimin e për të festuar së bashku. Një grup tjetër shqiptaro-amerikanësh kujtonin çfarë kishin dëgjuar nga baballarët e tyre që u ndodhën në meshën e parë shqipe të Fan Nolit. Sotir Pani, i biri i patriotit Vasil Pani, më tregoi se në kishën shqiptare të themeluar më 1908, kryetari i këshillit të kishës u zgjodh Misto Millona (Stojani), anëtarë të këshillit ishin Sotir Peci dhe Kostë Mangelli, i cili kryente detyrën e arkëtarit të kishës (që të tre dardharë)... Kalimthi dëgjoja biseda të bostonianëve të vjetër: “U mblodhëm për Fan Nolin sonte, këtu!” “Jo! Nuk u mblodhëm për

Fan Nolin, por Fan Noli na mblodhi sonte të gjithë këtu...Ashtu siç do të na mbledhë edhe kur të bëhet shenjt!”... Imzot Noli ka qenë i shenjtëruar në zemrat e shqiptaro-amerikanëve që janë pagëzuar prej tij e lyer me balsamin e atdhedashurisë...dhe në pleqëri, kur kanë vdekur, kanë përmendur emrin e tij t’i marrë në parajsë.

Ndërkohë pjesëmarrësit kaluan në sallën e festës, u ulën në tavolinat e rrumbullakta, zbukuruar me flamurë shqiptarë e amerikanë. Në skenën e improvizuar me këtë rast, prane monitorit, ekranit të madh në mur, ishin vendosur flamurët shqiptar e ai amerikan. Hyrja në sallë e presidentit Topi dhe e delegacionit shqiptar u prit me duartrokitje e brohoritje. Në podium u ngjit zonja Lauren Gregory, e cila u uroi mirëseardhjen të ftuarve, miqve e pjesëmarrësve dhe lexoi listën e të ftuarve si më poshtë:

The Right Reverend, Bishop NIKON (Liolin)  
Bishop of Boston, Neë England and the Albanian Arçdiocese  
in the U.S.,

The Most Reverend, Metropolitan JOAN (Pelushi)  
Bishop of the Diocese of Korça and representative of the Holy Synod  
of the  
Orthodox Çurç of Albania,

The Right Reverend Bishop ILIA (Katre) of Philomelion and the  
Albanian Orthodox Diocese of America of the Ecumenical Patriarçate,

His Excellency, Dr. Bamir Topi, President of the Republic of Albania  
and the First Lady, Teuta,

The Very Reverend Arthur Liolin

Çancellor of the Albanian Orthodox Arçdiocese in America, and priftëresha  
Margaret,

Ambassador Dr. Aleksander and Mrs. Shashenka SALLABANDA  
Albanian Ambassador to Vashington, D.C.,

Ambassador Besnik and Mrs. Eva KONCI  
Albanian Ambassador to Ottaëa, Canada,

Mr. Stefan KOÇI and wife, Elizabeth  
Honorary Counsel of the Republic of Albania in Boston,

The Reverend NUE GJERGJI  
Albanian Roman Catholic Çurç of Beverly Hills  
Arçdiocese of Detroit,

Jim BELUSHI  
Albanian American Actor,

The Reverend IMAM GAZMEND AGA  
of Vaterbury, CT and the Albanian Muslim Community  
of the U.S. and Canada,

BABA EDMOND HARADINAJ  
Zevendës Kryetar i Kryegjyshatës Bektashiane në Tiranë,

The Very Rev JOHN KRETA, Çancellor  
Diocese of Neë England  
Orthodox Çurç in America,

The Very Rev ROBERT ARIDA  
Dean of The Cathedral of the Holy Trinity in Boston,

The Very Rev. Arçimandrite Theophan KOJA  
of the Romanian Episcopate,

Dr. ÇARLES LINDERMAN  
International American Hospital project in Tirana,

Mr. PETER KOLE, Major Benefactor of the Theological Student Fund  
training future clergy both at Seminaries here and in Albania,

Mr. EKREM BARDHA, noted benefactor and philanthropist,

The ATHANAS FAMILY: Anthony, Robert, Miçael and Paul  
djemtë e Andon Athanasit,

Mr. Miçael and Lauren Gregory

CoChairman of the Albanian Orthodox Archdiocese Centennial,

Mr. AGIM REXHA Vice-President  
Pan Albanian Federation of America – VATRA,

Mr. AGIM SEJDIU, President  
Albanian Kosovar Society of Boston,

Mr. HARRY BAJRAKTARI & LOUIS FOUNDOS  
National Albanian American Council [NAAC],

Mr. BASHKIM BRAHO  
Çameria Human Rights Organization,

Mr Mark KOSMO and Ms. Albana ORGOCKA  
Massachusetts Albanian American Society [MAAS/BESA],

Mr John LULGJERAJ and officers of the  
Albanian American National Organization (AANO),

Ms Polikseni MANXHARI  
Miss Teen Massachusetts,

Roland Tasho  
Noted Photographer from Tirana

Merrnin pjesë gjithashtu Liza Mrijaj, shefe e zyrës së bashkisë së Yonkers-it, Rasim Hasani, kryetari i komitetit shtetëror të kulteve, dr. Gjon Buçaj, z. Altin Alimehmeti, znj. Merita Bajraktari McCormack e shumë personalitete të tjera.

Më pas, zonja L.Gregory ftoi në podium bishop Nikonin, bishop i Bostonit, i Nju-Inglandit dhe i kryedioqezës shqiptare. Peshkop Nikoni bëri bekimin e mbrëmjes si vijon:

“Në emër të Atit, Birit e Shpirtit të Shenjtë!

O Zot! Ne lutemi që ju të na vështroni poshtë mbledhjen tonë së bashku në këtë 100- vjetor të Kishës Ortodokse Autoqefale në Amerikë...

...Këtë moment shekullor falënderojmë gjithë burrat dhe gratë që përkushtuan jetët e tyre për t'i shërbyer bashkësisë sonë të shenjtë për shpëtimin dhe edukimin e bashkëqytetarëve tanë. Sipas shembullit të Fan Nolit, si luftëtarë të drejtësisë dhe të së vërtetës, ata të reflektojnë dashuri hyjnore dhe shkëlqimin e çdo përpjekjeje të çmuar.

**Si shërbyes i Perëndise dhe i njerëzve të tij, Fan Stilian Noli gjeti shprehjen e plotë të besimit të tij dhe mësoi lirinë në Shtetet e Bashkuara dhe ënderroi t'i shihte ato të plotësuara në Shqipëri. Perëndia ynë na e dha Nolin si dhuratë të veçantë dhe si dritë udhëzuese për jetët tona.**

O Zot! Bekona ushqimin e pijen e tavolinës sonë dhe të gjithë ne që jemi mbledhur sonte këtu, dhe të gjithë të dashurve tanë që janë këtu dhe atyre që kanë shkuar para nesh. Amin! “

Në çast, të 1000 pjesëmarrësit e sallës u ngritën në këmbë për të nderuar Himnin Kombëtar të Amerikës e të Shqipërisë. Tek-tuk nëpër tavolina himnet u shoqëruan edhe duke kënduar. Në monitorin e murit valëvitëshin flamurët amerikanë e shqiptarë të pasuar nga fotografitë e Fan Nolit gjatë aspekteve të ndryshme të jetës së tij. Ndërkohë u servir darka dhe peshkopi Ilia Ketri, Episkop i Filomelionit, dioqeza ortodokse shqiptare në Amerikë, u ngjit në podium dhe bekoj darkën:

“ Krisht, o Perëndia ynë, beko sonte këtë tryezë. Për shumë vjet gëzuar për këtë përvjetor historik ku marrim pjesë me gëzim e lumturi”.

Gjatë darkës, Mr. Miçael Gregory, duke folur në gjuhën angleze përshkroi historinë 100-vjeçare të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Ai përmendi celebrimin e liturgjisë së parë shqipe më 1908, duke filluar kështu organizimi i kryekishës së Shën Gjergjit në komunitet. Kisha shqiptare mirëpriti, përkrahu dhe u dha strehë emigrantëve të parë shqiptarë, si dhe atyre që mbërritën gjatë dy shekujve. Kryekisha e Shën Gjergjit e kryesuar nga Fan Noli nuk luajti vetëm rol “kishtar” por edhe një rol “shpirtëror”, duke i bërë të ndërgjegjshëm shqiptarët për të drejtat legjitime që duhej të gëzonte kombi shqiptar...”Duke kujtuar liturgjinë e parë të shenjtë, ne i drejtojmë sytë drejt së ardhmes”, -tha zoti Gregory...Më pas e mori fjalën znj. Ruth Karcines, njera nga ideatoret, organizatoret dhe mbështetëset aktive të kësaj mbrëmjeje. Ajo përmendi me respekt e dashuri emrat e prindërve të saj shqiptarë dhe i falënderoi për edukatën që i kishin dhënë, për të qenë krenare që ishte shqiptare.

Të pranishmit e shoqëruan me duartrokitje presidentin shqiptar Bamir Topi kur ai iu afrua podiumit. Në fjalën e tij përshëndetëse presidenti tha: “Është privilegj dhe kënaqësi e madhe që sot gjendem mes jush, në mes të bashkëkombasve të mi, për të kremtuar së bashku 100-vjetorin e Kishës Ortodokse Shqiptare në Amerikë, të këtij institucioni monument për kujtesën tonë, në të cilën Imzot Noli meshoi në shqip për herë të parë për shqiptarët dhe me të drejtë, Konica i madh e quan këtë ngjarje, pikë kthese të historisë sonë. Duke kremtuar këtë përvjetor të njëqindtë, bashkë me të kujtojmë sakrificat e themeluesit të këtij tempulli për shqiptarët, Fan Nolin, i cili për një shekull i bashkoi, u ndriçoi rrugën e jetës, u dha shpresë në çastet e dëshpërimit, u dha dashuri e harmoni mes njeri-tjetrit, u mësoi se si të pendohen, të falin dhe të ndihmojnë njeri-tjetrin. Këtë mund ta bënte vetëm një njeri me përmasa të mëdha shpirtërore, patriotike e kulturore. Shqiptarët qenë fatlumë, që në një kohë të vështirë në vitin 1908, Zoti u dërgoi si dhuratë Nolin për t'i bashkuar, organizuar dhe orientuar në rrugën drejt zhvillimit e integritetit në shtetin amerikan, por duke ruajtur gjallë vlerat dhe kulturën e kombit të tyre. për Imzot Nolin ndiejnë të njëjtën dashuri e respekt si ortodoksët, si myslimanët dhe katolikët, pasi ai i deshi të gjithë me të njëjtën dashuri dhe përkushtim, pa i dalluar nga feja e besimi...Tradicionalisht, të gjitha besimet ndër shqiptarë: myslimanë, ortodoksë e katolikë, kanë pasur dhe propaganduar si

qëllim kryesor bashkëjetesën mes tyre, respektin për njeri-tjetrin, duke u mbështetur në parimin “barazisht të rëndësishëm dhe barazisht të ligjshëm”. Në këtë mënyrë, shqiptarët trashëgjuan dhe ruajtën ndër breza këtë pasuri të madhe, në sajë të së cilës jetojnë në paqe e harmoni me njeri-tjetrin. Të edukuar me këto tradita, shqiptarët e Amerikës nuk kursyen asgjë nga pasuria e tyre, nga sakrificat dhe jeta e tyre, kur nevoja thërriste për kauzën shqiptare. Ne i njohim kontributet e Diasporës për të mbështetur hallet e Shqipërisë përgjatë një shekulli, që nga koha e pavarësisë e deri në ditët e sotme. Lobingjet e fuqishme të Diasporës bënë të mundur që zëri i Kosovës të dëgjohej pastër në Kongresin Amerikan dhe në Departamentin e Shtetit dhe për ta çuar atë zë kaq fuqishëm deri në ato nivele, ne e dimë që ju keni sakrifikuar shumë. Por le t’i jemi mirënjohës Zotit që sakrificat tuaja dhe të të gjithë shqiptarëve së bashku, nuk shkuan dëm, sepse sot kemi një Kosovë shtet të pavarur, e cila po ecën në rrugën e konsolidimit dhe kemi një Shqipëri që gjithnjë e më shumë po i afrohet hyrjes në Evropë. Shqipëria dhe Kosova janë krenare, që bijtë e tyre janë të suksesshëm në diasporë, kanë ditur të integrohen fuqishëm në jetën ekonomike e sociale të Amerikës, janë integruar si qytetarë të devotshëm e të kulturuar duke asimiluar vlerat demokratike, që ky vend përfaqëson...Para tri ditësh isha me Presidentin e Kosovës, Sejdiu në OKB, ku që të dy mbrojtëm krijimin e shtetit të ri e të pavarur të Kosovës, si një vend multi-etnik që respekton të gjitha të drejtat e minoriteteve. Shqipëria, Kosova dhe mbarë kombi shqiptar u janë mirënjohës Shteteve të Bashkuara dhe popullit amerikan për të gjitha ato që kanë bërë. Presidenti Sejdiu më kërkoi t’ju përcillja urimet dhe përsëritjet më të përzemërta në këtë përvjetor të shënuar. Shqipëria është pranë jush dhe unë, si President i Republikës, kam ndjeshmërinë dhe vëmendjen e madhe që raportet me Diasporën, kudo që ajo ndodhet, të jenë shpirtërore, intensive e të vazhdueshme, në mënyrë që të gjithë shqiptarët në çdo çast të ndihen si në atdheun e tyre të shenjtë”, - përfundoi presidenti. Fjalimi i tij u prit me duartrokitje dhe falënderime.

Presidenti i Republikës Bamir Topi dekoroi Kryekishën e Shën Gjergjit me urdhërin “Naim Frashëri” i Artë. Pas leximit të dekretit përkatës nga sekretari i përgjithshëm i institucionit të Presidencës z. Aleksandër Flloko, Presidenti Topi i dorëzoi peshkop Nikonit dekoratën e lartë me këtë motivacion: “ Për kontribut të shquar në Lëvizjen Kombëtare për fitoren e pavarësisë dhe ndërtimin e Shtetit Shqiptar, vatër e pashuar e patriotizmit, e edukimit të shqiptarëve pa dallim feje për ruajtjen e kulturës, traditave dhe dashurisë për Atdheun dhe Kombin, me aktivitet të pandërprerë për përparimin dhe prosperitetin e tyre.”

Me një dekoratë të dytë Presidenti i Republikës nderoi Imzot Fan S. Nolin, pas vdekjes, me urdhrin e lartë “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” me këtë motivacion: “Personalitet i shquar, luftëtar i madh i çështjes kombëtare për lirinë, gjuhën shqipe, kulturën kombëtare, për pavarësinë dhe ndërtimin e shtetit, pikë referimi në shumë plane në historinë e vendit, me kontribut të jashtëzakonshëm në lartësimin e përparimin e Atdheut dhe Kombit Shqiptar”. Urdhri i lartë iu dorëzua pasardhësit të denjë të Imzot Nolit, At Artur Liolinit, i cili mbajti një fjalim falënderues si më poshtë:

**Të nderuar klerikë, Zoti President, miq të vyer dhe bashkatdhetarë!**

**Në emër të kishës dhe komunitetit në Boston dhe në Shtetet e Bashkuara pranojmë me perulje të madhe dhe mirënjohje të thellë Medaljen e Urdhrit të Gjergj Kastriot Skënderbeut që i jepet themeluesit tonë, Kryepeshkopit Fan Stilian Nolit.**

Gjatë këtij 100-vjeçari ne i jemi mirënjohes Zotit President, i cili na kushtoi kohën e tij dhe erdhi të nderojë themeluesin tonë: Metropolitanin Theofan Stilian Noli.

Jeta e tij u shtri në dy shekuj dhe vepra e tij lidhi dy kontinente. Lindur më 1882, ai deshmoi dy epoka në historinë e popullit të vet. E para ishte koha e rigjetjes së identitetit të tij të humbur. E dyta ishte periudha e luftës për kombësi dhe shtetësi të mbarë.

Njëqind vjet përpara, më 1908, ai themeloi një kishë shqiptare ortodokse të pavarur në Boston, që më vonë u transmetua në atdhe. Gjatë jetës së tij të jashtëzakonshme ai sherbeu si Ministër i Jashtëm i Shqipërisë duke siguruar në Lidhjen e Kombeve njohje ndërkombëtare për të parën herë për vendin e tij. Aftësitë e tij si burrë shteti arritën kulmin kur ai u bë kryeministri demokrat i parë i vendit.

Ne jetën e tij të shumanshme ai ndikoi jo vetëm popullin e tij, por edhe shumë të tjerë në frymën e ekumenizmit e të tolerancës së vërtete. Ai perktheu liturgjinë e shenjtë në shqipe dhe më pas në anglishte, po ashtu perktheu edhe vepra të Shekspirit, Ibsenit, Cervantesit dhe Longfellowit e të tjerë shkrimtarë luminozë. Ai kompozoi një simfoni dhe u bë shkollor i njohur i Bethovenit dhe i Skenderbeut, Heroi kombëtar i Shqipërisë. Njohja e tij si një burrë i rrallë u pranua jo vetëm në atdhe, por edhe në Shtetin e Bardhe, në SHBA, si dhe në vende të tjera... Jeta e tij tejkalon lidhjet e thjeshta të tokës dhe ngrihet gjithmonë të na frymëzojë dhe të na inkurajojë, pasi në zemrën dhe shpirtin e tij ai shpeshoi gjerat që janë përtej së përkohshmes, në përpjekjet jetësore ai kërkoi Mbretërinë e Perëndisë – dhe ta ndajë atë me njerëzit e tij dhe me gjithë të tjerët.

Gjate këtij viti të 100-vjetorit ne kemi gëzuar dhe nderojmë jetën e tij me arritje si klerik, burrë shteti, shkollor, poet dhe autor në një udhëheqje të jashtëzakonshme, që kërkoi të lidhë gjithë ç’janë të vlefshme, të perjetueshme dhe të larta dhe shpeshoi për parajsën në tokë.

Per trashëgiminë e tij dhe të të gjithë burrave, grave dhe femijëve të diasporës sonë, ne jemi thellësisht mirënjohës për këtë çmim të vyer në njohje të Fan Nolit.”

X X X

Tingujt e ritmit të daulles shqiptare buçitën në skenën e improvizuar. Valltarët e grupit “Bashkimi” të Bostonit, më shumë se çdo herë, treguan talentin, mjeshtërinë dhe atdhedashurinë, duke përcjellë ndjenjat tona në vallet e tyre të bukura. Ishte mjaft prekëse e domethënëse “Vallja e Çamërisë” me të cilën ky grup ka korrur suksese kohëve të fundit. Bostonianët i drejtuan fjalët më të mira falënderuese këtij grupi, i cili ua shton harenë e hijeshinë festave që organizojnë shqiptaro-amerikanët në mbarë Amerikën...Për të ndjekur zhvillimin e mbrëmjes ishte i pranishëm si gjithnjë Arben Kamberi me grupin e tij të qendrës së televizionit “Bota shqiptare” në Uster, MA, i kudondodhur e i falënderuar për pasqyrimin dhe shfaqjen e të gjitha ngjarjeve historike të zhvilluara në Boston e në gjithë Massachusettsin. Nga Nju-Jorku ishin të pranishëm: Z Dalip Greca nga redaksia e gazetës “Illyria”, TV “Kultura Shqiptare”, z Beqir Sina e të tjerë.

Takohem me Kryetarin e Komitetit Shtetëror për Kultet pranë qeverisë shqiptare, z Rasim Hasanaj, i cili përshëndet: “Me këtë festë shfaqet edhe një herë tradita e bukur e këngëve dhe valleve të mrekullueshme shqiptare, që flet për edukimin atdhetar solid që ju kanë përciell prindërit e gjyshërit tuaj edhe pse shumë prej pjesëmarrësve në festë kanë lindur në SHBA...Me kënaqësi konstatoj se festa si kjo e 100-vjetorit janë vazhdim i traditës së organizimeve të tilla nga vetë Noli ynë i madh...” Më tej z Hasanaj vazhdoi : “ Ruajtja dhe promovimi i vlerave të harmonisë fetare mes shqiptarëve është një pasuri autentike shumë e çmuar e popullit tonë, që e ka bërë Shqipërinë model në botë për marrëdhëniet ndërfaqetare.”

Nga bokset e mureve shpërndahej muzikë shqiptare ndërsa pjesëmarrësit lëviznin nëpër tavolina, takoheshin, përshëndeteshin, bënin fotografi, përgëzonin fëmijët. Një zë vajze tërhoqi vemendjen. Hipur në një podium vogëlushja me emrin Zana recitoi peezinë e Fan Nolit “Jepni për Nënë”:

Ç’thotë ajo e ve e gjorë,  
Mbretëreshë pa kurorë,  
Faqe-çjerrur, lesh-lëshuar,  
Shpirt e zemër përvëlur,  
Gjysm’ e vdekur : O shqiptarë,  
Nënës mos ja bëni varrë.  
Mbahu, Nëno, mos kij frikë,  
Se ke djemtë n’Amerikë.  
Qan e lutet nën’ e mjerë,  
Kërkon vatrën edhe nderë,  
Do lirinë dhe atdhenë  
Siç e pat me Skënderbenë.  
Bijt’ e besës thërret pranë.  
Kur i thirri e s’i vanë?  
Mbahu, Nëno, mos kij frikë,  
Se ke djemtë n’Amerikë.

.....  
Cila Nënë lyp paranë,  
Cilët bij me shpirt s'ia dhanë?  
Mbahu, Nëno, mos kij frikë,  
Se ke djemtë n' Amerikë.  
Armë e fishekë mblidhni,  
Qesen edhe shpirtin hidhni,  
Për lirin' e vendit tonë  
Sot, se nesër është vonë!  
Jepni, Nënë të shpëtoni,  
Komb e vatra të nderoni,  
Mbahu, Nëno, mos kij frikë,  
Se ke djemtë n' Amerikë...

Është bërë traditë tani në diasporë që në kremtime festash kombëtare një vajzë e vogël reciton “Jepni për Nënë” duke i bërë jehonë vogëlushes Nazife Bilali, e cila e recitoi për herë të parë këtë poezi një shekull më parë, duke mallëngjyer zemrat e mërgimtarëve në Amerikë e kudo në botë. Zana e vogël i recitoi me dëlirësi e ndjenjë ato vargje që ndoshta nuk ua dinte mirë kuptimin, sidoqoftë ajo e shpërnda mesazhin mes shqiptaro-amerikanëve që mbushnin sallën.

Pak më tutje qëndronte tërë nur e bukuri Miss Teen Massachusetts, zonjusha Polikseni Manxhari, qafë sorkadheja, me një kurorë xixëlluese në kokë dhe me shiritin e bardhë, trofenë e fitueses, qarkuar në krah e në gjoks. Ndoshta kjo bukuroshe u bë shkas për atë çka tha më vonë aktori i dëgjuar me origjinë shqiptare Xhim Belushi, gjatë fjalimit të tij përshëndetës, sepse i kishte lënë përshtypje bukuria e vajzave shqiptare kur udhëtoi në Shqipëri. Dalja në podiumin e festës e të ftuarit special Xhim Belushit u prit me duartrokitje e thirrje të gëzuara nga të pranishmit, sidomos nga ata në moshë të re. Fjala e parë që ai tha në shqipe “Unë jam shqiptar!” elektrizoi sallën me duartrokitje e britma të hareshme. Brohoritjet u shtuan edhe më tepër kur të ftuarit amerikanë e mësuan këtë hollësi të jetës së tij e nuk u besonin veshëve...Fjalimi i Belushit ishte me humor, rreth kujtimeve të jetës së tij dhe të të vëllait, rritur në një familje me tradita shqiptare me origjinë nga fshati Qytezë e rrethit të Korçës. (Qytezë quhej dhe një fshat tjetër në Thrakë, ku u lind Fan Noli)...Belushi ruante në kujtesë dashurinë për gjyshen e tij, “nanën”, që kurrë nuk i mësoi dy fjalë anglishte. Ai ruante kujtime nga kisha e Çikagos kur vinin të dielave me familjen. Ai i kujtonte me respekt prinderit e tij, babanë, i cili erdhi nga Qyteza më 1916 dhe punoi rëndë në Çikago. Nën shembullin e të atit u bënë punëtorë edhe dy vëllezërit që zotëronin në të njëjtën kohë edhe talentin e madh të aktorit...Devollinjtë që merrnin pjesë në këtë festë, nuk e përmbanin dot krenarinë. “Mos më thoni që më keni kushëri,- u thoshte Xhimi atyre,- deri tani jam bërë me mijëra kushërinj!...”

Fjalimin e tij Xhim Belushi e përfundoi me kujdesin që duhet treguar për edukimin e fëmijëve në Shqipëri. Ai e përsëriti disa herë: “Të ndihmojmë fëmijët!” Ai ishte befasuar kur kishte dëgjuar se 25% e nxënësve të shkëlqyer në shkollat e Bostonit ishin shqiptarë... Kryekisha e Shën Gjergjit i dhuroi një medalje Belushit dhe informoi se do të bëhen donacione në emër të Xhim Belushit për “Shtëpinë jetimore” në Durrës, që mbështetet nga kisha ortodokse. Aktori i madh do të niset së shpejti për në Shqipëri. “Të suportojmë Shqipërinë!” ,- ishte fjala e tij e fundit.- Kjo mbrëmje festive na ka mbledhur të gjithë së bashku, ortodoksë, katolikë, myslimanë...të gjithë jemi shqiptarë!”

Pas fjalimit Xhim Belushi dha një koncert të improvizuar, spektakolar, duke kënduar i shoqëruar nga orkestra e John Keegan. Çdo këngë e tij u shoqërua me duartrokitjet e brohoritjet e të pranishmëve në sallë. Sidomos kënga “Çikago”, kur Belushi, duke kënduar, në vend të fjalës “Çikago” përdorte fjalën “Tirana”. Më tej në sallën e mbrëmjes pasoi kënga e vallja shqiptare shoqëruar me muzikë nga grupi i Gjergj Trebickës.

Me këtë koncert u mbyll dhe festa “Grand-Gala”, një kremtim madhështor i shqiptaro-amerikanëve, me urimin shpirtëror që kjo ditë të përkujtohet edhe pas 100 vjetëve të tjerë në komunitetin e Bostonit, i cili do të mbijetojë e do të trashëgohet.

**KËMBANA E KISHËS SË FAN NOLIT NË SOUTH BOSTON TINGËLLOI PËR TË NJËQINDTËN HERË!**

**MESHA E 100- VJETORIT NË KRYEKISHËN ORTODOKSE SHQIPTARE**

**TË SHËN GJERGJIT**

Ditën e diel më 28 shtator 2008 kryekisha e Shën Gjergjit zhvilloi Meshën e 100- vjetorit të liturgjisë së shenjtë në kujtim dhe nderim të themeluesit të kishës së parë shqipe Theofan S Noli...Sa herë hyj në kishën e Shën Gjergjit më bëjnë përshtypje lulet shumëngjyrëshe që zbukurojnë oborrin dhe busti prej bronzi i Imzot Nolit në hyrje, në të majtë të derës së jashtme. Mëngjesin e së dielës, më 28 shtator, putha kryqin varur në qafë të bustit të Fan Nolit dhe u drejtova në mjediset e brendshme të tempullit. Ishte një e diel e pazakontë: qindra besimtarë e të ftuar, shqiptarë e amerikane, me nga një flamur të vogël në dorë, dhuruar nga kisha, bisedonin e përshëndeteshin në minutat para se të fillonte shërbesa. Urimi “Mirë se erdhët” dëgjohej gjithandej nga anëtarët e këshillit të kishës dhe nga punonjësit e shërbimit.

Më tepër qe të binte në sy nuk ishte moria e pjesëmarrësve, por grupi i klerikëve shqiptarë të besimeve të ndryshme që dalloheshin nga njeri-tjetri nga veshjet karakteristike të stilit religjios . Në korridorin e madh takova studiuesin Tomë Mrijaj, i cili hapi bisedë rreth librit të tij shkruar për monsinjor dr. Zef Oroshi. Në një kapitull më vete “Noli dhe Oroshi” Toma përshkruan miqësinë dhe bashkëpunimin në vitin 1961 midis Imzot dr. Fan Stilian Nolit dhe dr. Oroshit. Tema kryesore e bisedës së tyre ishte ideja e afrimit të kishës ortodokse dhe asaj katolike sidomos në një formë të ndërkomunikimit (shumë vite më parë se të diskutohej në Vatikan)... Imzot Noli i kishte pohuar monsinjor Oroshit se ai kishte qenë gjithmonë një studiues i afërt i kishës katolike dhe se kishte qenë një admirues i kësaj kishë në Shqipëri dhe jashtë saj. Kjo

mbase lidhej edhe me bashkëjetesën shembullore të besimeve të ndryshme fetare në Shqipëri qysh me pavarësinë, pas vitit 1912...Shqiptaro-amerikanët e Detroitit kujtojnë me respekt se, kur Imzot Noli vizitonte Detroitin për të mbajtur meshën në kishën ortodokse të Shën Thomait, gjente kohën e përshtatshme për t'u takuar edhe me miqtë e tij myslimanë të xhamisë e të teqesë. Ky ishte dhe shkaku i popullaritetit të madh që gëzonte peshkopi në shqiptarët e Detroitit...

Ndërkaq, bëhemi gati të ulemi në fronat e kishës, ndërsa shohim të afrohen drejt altarit klerikët e 13 kishave ortodokse shqiptare të Amerikës. Historikisht këto kisha varen nga Kryekisha e Shën Gjergjit, e para kishë e themeluar më 1908 në Boston. Më tej pasojnë: kisha e Shën Ilias – 1911, Jamestown, Nju-Jork; kisha e Shënkollit—1912 ,Southbridge, MASS; kisha Fjetja e Shën Mërisë—1915, Uster, MASS; kisha e Shën Pjetrit dhe e Shën Palit—1915 , Filadelfia, PA; kisha e “Ungjillëzimit”—1919, Natick, MASS; kisha e Shën Gjergjit—1925 Trumbull, CT; kisha e Shën Thomait—1929—Farmington Hills, MI; kisha e Shën John Krysostom—1931 , Filadelfia, PA; kisha e Shën Jan Pagëzorit—1936, Boston, MASS; kisha e Shënepremtes—1938, Cleveland, OH; kisha e Shënkollit—1941, Jamaica Estates NY; kisha “Holy Trinity Mission” –2004 Folsom, CA.

Tashmë Mesha ka filluar, para altarit qëndron grumbulli i klerikëve ortodoksë, rreth 20 meshtarë, veshur të gjithë me pelerina të verdha-të arta, ardhur nga kisha të ndryshme të Amerikës e të Shqipërisë. Tek shoh atë grumbull klerikësh që lusin Meshën 100-vjeçare, kujtoj me nderim priftin e parë nga Shqipëria, emigrantin e parë shqiptar që shkeli tokën amerikane më 1886, At Nikolla Kristofori... Mesha historike e liturgjisë së 100-të të shenjtë Noliane u organizua nga i përndershmi At Artur Liolini—kancelar i Peshkopatës Ortodokse Shqiptare me qendër në Katedralen e Shën Gjergjit në Boston dhe u drejtua nga tre peshkopë: nga peshkopi Nikon—Episkop i Bostonit, i Nju-Inglandit dhe i Kryepeshkopatës Ortodokse Shqiptare në Amerikë; nga Metropolitani John Pelushi—peshkopi i Dioqezës së Korçës dhe përfaqësues i Sinodit të Shenjtë i Kishës Ortodokse të Shqipërisë; nga i Përndershmi Ilia Ketri—peshkop i Filomelionit dhe i Dioqezës Ortodokse Shqiptare të Amerikës të Ecumenical Patriarqate.

Në një tavolinë të vogël para altarit, si gjithmonë qëndron portreti i Fan Nolit rrethuar nga një hark i artë qirinsh të ndezur mes dy buqetash me trëndafilë të bardhë dhe zgorrofete... Flamuri shqiptar dhe ai amerikan ishin vendosur në të dy anët e altarit nën ndriçimin e qirinjmajtëseve të praruara. Në të djathtë të altarit anëtarët e korit kishin veshur devizën kuq-e zi, ngjyrën e flamurit. Kësaj dite të shënuar në grupin e korit merrnin pjesë edhe anëtarë nga koret e kishave të tjera shqiptare. Replika përsëritëse e korit “PËR SHUMË VJET!” dhe tymi i thimjanit që ngrihej lart e mjegullonte portretet e ikonave, krijonte një tablo imagjinare, jashtë hapësirës dhe kohës...Disa prej besimtarëve që morën pjesë në këtë meshë të jashtzakonshme, që i përkisnin brezit të dyte e të tretë të emigrantëve shqiptarë, e kanë edhe sot si të gjallë fytyrën e Fan Nolit të shenjtë, kujtimet për Imzotin e Shën Gjergjit dhe patriarkun më të shquar të atdhetarizmit shqiptar. Kujtimet për Fan Nolin, bisedat me të, takimet në sallat publike festive dhe në piknikët me këngë e valle, kontributi i penës së tij në edukimin patriotik të mërgimtarëve, dëgjimi i predikimeve të tij në kishë, në kurorëzimin e çifteve të reja, në pagëzimet e fëmijëve dhe në ceremonitë mortore...jane vlera të pashlyeshme që i mbart një komunitet i tërë shqiptaro-amerikan jo vetëm në Massachusetts, por edhe në krejt Amerikën. Arta Morison, shqiptaro-amerikani nga Usteri kur sheh portretin e Nolit me mjekër, kujton me humor se, kur ishte fëmijë dhe e çonin prindërit në kishë, e shihte me vërejtje Fan Nolin, veshur me rrobat e ndritura të peshkopit, por nuk i besohej të ishte klerik mbasi nuk kishte mjekër të rritur...

Shërbesa kishtare që zgjati 2 orë e 15 minuta, përfundoi me predikimin e tre peshkopëve.

Peshkopi Nikon bekoj Meshën dhe besimtarët duke tundur me dy duart, në shenjën e kryqit, dy tufa qirinsh lidhur me fjongo kuq-e zi. Më tej predikoi:

“Bijtë e mi shpirtërorë, klerikë dhe besimtarë të Kryepeshkopatës Shqiptare!

Krishti është në mes nesh. Ai është dhe gjithmonë do të jetë!

Unë ju përshëndes ju me dashuri dhe falënderim në shpirt që jemi mbledhur të kremtojmë 100- vjetorin e Kryepeshkopatës Shqiptare në Amerikë. Kur njera pjesë e trupit të Krishtit vuan, të gjithë vuajnë dhe, kur njera pjesë e trupit të Krishtit ringjallet dhe celebron, e gjithë kisha celebron!

Unë shfaq këtë gëzim në emër të gjithë kishës në kremtimin e këtij 100- vjetori.

Për më shumë se 100 vjet, klerikët dhe besimtarët e Kryepeshkopatës kanë marrë pjesë në jetën e kishës dhe në misionin e saj. Duke pranuar sfidat dhe kundërshtimet që janë pjesë e çdo veprimtarie të dioqezës, ne gjithashtu jemi ringritur me suksese dhe jemi bërë përfitues të shumë lutjeve të shenjta. Më e rëndësishmja është se për 100 vjet komuniteti ynë ka qenë i gatshëm të pranonte “the Gospel mandate”: “të shpallim Lajmin e Gëzuar!”

Le të jetë ky kremtim i përvjetorit të 100-të një ditë përkujtimore dhe një ditë me falënderime e gëzime për Zotin e lavdishëm, për bekimet që ai na ka dërguar gjatë këtyre dhjetë dekadave.

Le t’u dhurojë Zoti kujtim të përjetshëm klerikëve dhe besimtarëve të Kryepeshkopatës sonë që prehen në qetësi, dhe, “PËR SHUMË VJET!” atyre që vazhdojnë të punojnë në kopshtin e tij.”

Gjithashtu Peshkop Nikoni lexoi përshëndetjen dërguar nga Lumturia e tij Kryepeshkopi Anastas Janullatos, i cili falënderonte për pritjen që iu bë gjatë muajit mars 2008 për festimin e 100- vjetorit të kishës ortodokse të Amerikës së Veriut. Kryepeshkopi vazhdon me lavdërimet dhe nderimet për priftin e parë shqiptar Theofan Stilian Noli, që themeloi kishën e parë shqiptare në Amerikë dhe me kontributin e tij të jashtëzakonshëm arriti që të ndikonte edhe në kishën ortodokse të atdheut të tij. Ai e vlerëson Nolin si një personalitet, një person dinamik me horizonte të hapura e me ide krijuese për progres.

Kryepeshkopi përfundon se, si ortodoksë, ne kujtojmë të parët tanë jo vetëm historikisht, por edhe realisht, me Zotin, ata janë të pranishëm me ne, në lutjet e shërbesat tona; kjo nënkupton gjithashtu edhe ardhjen e gjeneratave të reja të besimtarëve pas nesh...

Në fund të letrës Kryepeshkopi dërgon urimet më të mira për unitet, dashuri, besim e prosperitet për Kishën Ortodokse Shqiptare të Amerikës.

Predikimi nga peshkopi Pelushi:

“ Hirësi i nderuar!

Të dashur motra e vëllezër!

Jam i gëzuar që ndodhem sot në katedralen e Shën Gjergjit, në këtë 100- vjetor të themelimit të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare!

Jam akoma më i gëzuar që ky përvjetor na gjeti të gjithë së bashku...Sepse bashkimi sjell gjëra të mira, i afron njerëzit akoma më pranë...Prandaj të përpiqemi e të lutemi për ta mbajtur e për ta ndihmuar kishën, se të gjithë kemi nevojë për kishën...se e duam njeri-tjetrin...Sepse sa më shumë të largohemi nga Zoti, aq më shumë largohemi nga njeri-tjetri e mbetemi të vetmuar jo vetëm jashtë familjes, por edhe brenda saj. Vetmia të sjell jetën pa gëzim...Prandaj ta mbajmë gjallë kishën, jo vetëm thjesht për të mbajtur gjallë identitetin tone, por për të mbajtur gjallë edhe shpirtërat tanë...”

Predikimi nga peshkopi Ilia:

“ Të dashur pjesëmarrës e besimtarë! Në këtë mëngjes të së dielës na ka mbledhur se bashku Lavdia e Shpirtit të Shenjtë të përkujtojmë 100- vjetorin e themelimit të Kishës Autoqefale Shqiptare. Kisha shqiptare më 1908 u krijua për ne, sot, një ditë oportune për ne, të vlerësojmë e të çmojmë përvojën tonë brenda kushteve që na i dikton koha e sotme në këtë komunitet.”

Peshkopi Ketri nënvizoi se shoqëria njerëzore e botërore sot përdor dialogun ndërfetar e kulturor për asye se ky është thelbi domethënës i të qenit njeri. Sipas hirësisë së tij, feja ka mundësi të shërbejë e të bëjë dialog jo vetëm për të shmangur armiqësinë mes njerëzve, por më tepër për të përballuar ndryshimet mes kulturave, duke predikuar mirëkuptimin dhe besimin e ndërsjellë. Feja ka mundësi të bashkojë e të miqësojë njerëzit me njeri-tjetrin.

“ Të dashurit e mi! Në këtë kishë të dëshmorit të parë, të Shën Gjergjit, në Boston, ku vetë Imzot Theofan Noli e ka bashkuar dhe ka predikuar në gjuhën e bukur shqipe, ne, pasardhësit e tij pas 100 vjetësh ruajmë dashurinë popullore, traditën kombëtare dhe zakonet e një populli të vjetër mijëra vjeçar.

Ky është me të vërtetë celebrimi i rëndësishëm, i ndershëm e plot kuptim.

Duke mbyllur këtë fjalim, dëshiroj të falënderoj hirësinë e tij Imzot Nikonin për të më dhënë nderin e fjalës. Njëkohësisht e përgëzojmë për organizimin e festimit dhe i urojmë suksese të mëtejshme në misionin e tij shpirtëror.

**PËR SHUMË VJET, O KRYEZOT!**

Faleminderit.”

Mesha përfundoi me përsëritjen ritmike të replikës së korit : “PËR SHUMË VJET!” si një mesazh mirësie e përjetësimi.

## I PËRJETSHËM KUJTIMI I FAN NOLIT

Ditën e diel më 28 shtator 2008, pas shërbesës kishtarë historike në katedralen e Shën Gjergjit, në orën 12:00 shqiptaro-amerikanët u nisën për në parkun “Forest Hills Cemetery” për të bërë homazhe në varrin e Fan Nolit. Shiu i mëngjesit sa kishte pushuar dhe në ajër ishte ndehur një mjegull e tejdukshme. Për tri ditë rresht nuk pushoi stuhia zhurmëmadhe, shirrjedhëse “Hurricane Kyle”, e cila nuk pengoi aspak pjesëmarrjen dhe manifestimet e programuara të 100-

vjetorit. Tani varri i Imzot Nolit ishte zhytur në një aureolë përgjumjeje sikur ai gur varri t'i kishte thithur të gjitha stuhitë e tani shpërndante vetëm paqe e qetësi.

Presidenti i Republikës, Bamir Topi, i shoqëruar nga Zonja e Parë Teuta Topi dhe delegacioni zyrtar bëri homazhe në varrin e Fan Nolit. Presidenti Topi vendosi një kurorë me lule në varrin e Fan Nolit duke nderuar për disa minuta. Kurora ishte thurur me lule të kuqe dhe në shiritin e zi ishte shkruar me gërma të arta: “Në nderim të Fan S. Nolit”. Pas nderimit presidenti Topi tha: “Në këtë vend të pelegrinazhit kombëtar, kisha dëshirë të isha patjetër me ju sot, për t'i bërë homazhe së bashku këtij burri të madh të kombit shqiptar, që edhe sot pas njëqind vjetësh, vepra e tij është një libër i shenjtë, vazhdon të iluminojë fuqishëm rrugën e shqiptarëve drejt civilizimit, përparimit e demokracisë... Duke e përmbledhur të gjithë kontributin e tij, mund të them se, aq mirë i ndërtoi themelet e një Kisha dhe Komuniteti të edukuar shqiptar, themelet e gjuhës, historisë dhe kulturës kombëtare, të vizionit liberal për shtetin, sa dhe sot, pas një shekulli, ndihemi krenarë dhe përulemi me shumë respekt për veprën e Imzot Nolit.”

Presidenti shqiptar po ashtu, bëri homazhe, nderoi dhe vendosi një kurorë me lule edhe te varri i Faik Konicës.

Shqiptaro-amerikanët u përulën me nderim dhe vendosën buqeta me lule mbi varrin e Nolit. Nuk është hera e parë që vij para varrit të tij. Dhe çdo herë, ai gur i gdhendur me një shqiponjë e një kryq jep një mesazh të ri... Këtë varr në një shkrimin tim e kam cilësuar “katakomb i mërgimit”. Presidenti Topi e emëroi bukur: “Vend i pelegrinazhit kombëtar”, që të kujton përjetësinë.

”Kryeje me zjarr detyrën e gjatë e të vështirë që të ka caktuar fati!...” Këto vargje të shkëputura i përkasin elegjisë romantike “Vdekja e ujkut”, poezi franceze nga De Vinj.(De Vigny). Ky libër u gjend në tavolinën e Fan Nolit pas vdekjes. Vargjet e mësipërme ishin nënvizuar nga ai e ndoshta përmbledhin jetën e tij.

## PËR SHUMË VJET—TË BASHKUAR

Në goftë se kombin shqiptar do ta përfytyronim gjeografikisht, historikisht dhe shpirtërisht, gjatë festimeve të shtatorit 2008 në Boston për 100- vjetorin e Kishës Autoqefale Shqiptare, ne e pamë dhe e prekëm edhe kombin shpirtërisht. Pjesëmarrës nga gjenerata të ndryshme, nga të gjitha trojet etnike, nga të gjitha besimet fetare, nga ide e përkatësi partiake të ndryshme, mbledhur së bashku, si një familje e madhe në Diasporë. Dhe kjo familje kishte mik të festës presidentin shqiptar, i cili shfaqti dashurine dhe respektin për shqiptaro-amerikanet dhe përshëndeti: “Përkujtimi i 100- vjetorit të Meshës së Parë në Shqipëri të na shërbejë të gjithëve për të kujtuar të kaluarën shembullore të popullit shqiptar e të krenohemi me të! Le të na nxitë të jemi më pranë e më të bashkuar me njeri-tjetrin në rrugën drejt së ardhmes!”

Gjeneratat shkojnë e vijnë, regjimet shtetërore shkojnë e vijnë, por idetë mbeten përgjithnjë.  
Dhe ideja e shqiptarit është shqiptarizma.